



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 14
Prishtinë, 10 qershor 2008, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Flora Brovina, Nurishahe Hulaj, Gjylnaze Sylja, Qamile Morina, Armend Zemaj dhe Teuta Hadri.

Munguan: Sllobodan Petroviq, Rita Hajzeraj, Mimoza Ahmetaj dhe Bujar Bukoshi.

Të pranishëm: nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta- nëpunëse administrative.
Nga NDI-Shefki Kastrati,
Nga USAID-Haxhi Gashi.

Mbledhjen e kryesoi z. Sadik Idriz, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për punë;**
- 4. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa plotësim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për punë

Sadik Idriz – Tha, para se Komisioni të fillojë me amendamentimin e Projektligjit për punën, Komisioni duhet ta organizoj një dëgjim publik, në të cilin do të ftohen të gjithë të interesuarit si: përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, të Ministrisë për Ekonomi dhe Financa, përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit, sindikatat, organizatat ndërkombëtare, përfaqësuesit nga Zyra Ligjore e Kryeministrit etj. Është mirë të merret edhe mendimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me implikimet buxhetore të këtij projektligji, para amendamentimit. Propozoj që dëgjimi publik të mbahet më 24 qershor 2008. Ai propozoi që për këtë projektligj të caktohet një grup pune, në përbërje të të cilit do të jetë nga një përfaqësues i grupeve parlamentare në këtë Komision. Hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Gjynaze Syla- Tha se, më parë duhet të caktohet një grup raportues dhe propozoi që kryesues i këtij grupi të jetë kryetari i këtij komisioni z. Sadik Idriz. Komisioni duhet të ketë të dhëna se cilët do të jenë ekspertët që do të mund të kontribuonin në shqyrtimin e këtij projektligji. Ajo tha se e ka analizuar hollësisht Projektligjin për punën dhe ka konstatuar se ky projektligj nuk i përfshin shërbyesit civilë dhe publikë, por i rregullon marrëdhëniet e punës vetëm në sektorin privat. Ajo propozoi që në dëgjim publik të ftohen: përfaqësuesit e Aleancës Kosovare të Biznesit, përfaqësuesit e Odës Ekonomike, përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare, si dhe përfaqësuesit e Komisionit Evropian.

Ajo po ashtu propozoi që, para se të mbahet dëgjimi publik për Projektligjin e punës, në mbledhjen e ardhshme të Komisionit të ftohen për t'u dëgjuar përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, si dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave. Të dëgjojnë ekspertët e angazhuar për këtë projektligj në mënyrë që Komisioni të marrë informacione të nevojshme për politikat e sponsoruesit lidhur me këtë projektligj si dhe për implikimet buxhetore të këtij projektligji. Propozimin që të ftohen edhe përfaqësues nga Zyra e Kryeministrit ajo e konsideron të panevojshëm.

Teuta Hadri-Tha se Ligji për punën është ligj bazik për sektorin privat. Në këtë ligj nuk përfshihen shërbyesit civilë, ata do të trajtohen kategori tjetër. Sipas informatave që ka ajo, Ministria e Shërbimeve Publike është duke e përgatitur ligjin për shërbyesit civilë. Punëtorët e sektorit privat duhet të trajtohen njësoj si punëtorët e shërbimit civil, sidomos sa i përket pushimit të lehonisë, që në sektorin privat është shfrytëzuar me kohëzgjatje vetëm 3 muaj. Ky ligj është bërë për ta penguar diskriminimin e punëtorëve në sektorin privat.

Haxhi Gashi (USAID) - Tha se USAID-i do ta mbështesë këtë komision lidhur me amendamentimin e Ligjit të punës. Ky ligj nuk i përfshin shërbyesit civilë. Kategoria e shërbyesve civilë e ka një trajtim tjetër. Tani është një fazë ku duhet të definohen qartë nocionet “shërbyes civil” dhe “shërbyes publik”. Ky ligj ka për qëllim t'i rregullojë marrëdhënien e punës në sektorin privat. Shërbyesit civilë nuk hyjnë në këtë kategori, sepse kriteret e punësimit janë të ndryshme, financimi

është i ndryshëm dhe kjo çështje mendohet të rregullohet me një ligj tjetër. Shtrohet dilema se si do të jetë statusi i punëtorëve në sektorin publik, si në PTK dhe KEK. Ndoshta do të hartohet edhe një ligj që do t'i rregullonte marrëdhëniet e punës në sektorin publik.

Nurishahe Hulaj – Tha se grupi i punës i këtij komisioni, për ta shqyrtuar Projektligjin për punën, duhet të jetë i përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha grupeve parlamentare të përfaqësuara në këtë komision, në mënyrë që të mos ketë konfuzion.

Ajo propozoi që në dëgjim publik të ftohen edhe menaxherët e organizatave publike dhe private-drejtorët e spitaleve rajonale dhe të qendrave kryesore të mjekësisë familjare, si dhe nga komunat përfaqësues të drejtorateve shëndetësore. Ajo propozoi që të ftohet eksperti slloven që ka punuar në mandatin e kaluar në këtë projektligj, sepse ky ligj është bazik prej të cilit do të dalin pastaj edhe ligje të tjera.

Ajo njoftoi anëtarët e Komisionit se Kryeministria ka formuar dy komisione: Komisionin për Mbikëqyrjen e Implementimit të Ligjeve dhe Komisionin për Kolizionet e Ligjeve. Ndoshta do të ishte mirë që Komisioni t'i dëgjonte edhe mendimet e këtyre dy komisioneve.

Armend Zemaj– Tha se pajtohet të formohet grupi i punës dhe të organizohet takimi me sponsoruesin dhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave, në mënyrë që të hiqen dilemat që i kemi për këtë projektligj. Të njoftohemi për qëllimet e sponsoruesit lidhur me këtë ligj si dhe për mundësinë e zbatimit të këtij ligji.

Flora Brovina – Tha se para disa ditësh ka marrë pjesë në një konferencë në Mal të Zi, ku Pakti i Stabilitetit kishte organizuar një diskutim rreth punësimit. Atje ajo ka marrë informacione se si janë ligjet e punës në rajon. Ligji i punës i Sllovenisë është shumë i mirë dhe Projektligji që është proceduar në Kuvendin e Kosovës është vetëm një pjesë e tij. Të pranishmit në diskutimin e organizuar nga Pakti i Stabilitetit, kanë shprehur interesimin për Ligjin e punës që është proceduar në Kuvendin e Kosovës edhe për ta mundësuar vizitën në një nga vendet e rajonit për ta parë për së afërmi praktikën e zbatimit të Ligjit të punës.

Qamile Morina – Tha se në Slloveni ka shumë ligje të punës. Faktikisht secili kapitull i këtij projektligji, që është proceduar në Kuvendin e Kosovës, është ligj i ndarë në Slloveni. Ajo tha se nuk e ka analizuar përmbajtjen e ligjit, por konsideron se ky ligj do të jetë problem për t'u zbatuar. Ajo tha se së pari duhet të bisedohet me sponsoruesit e pastaj Komisioni të vazhdojë me shqyrtimin e mëtutjeshëm të këtij projektligji.

Pas diskutimeve të deputetëve, Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Në mbledhjen e radhës të ftohen për t'u dëgjuar përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe të Mirëqenies Sociale, të Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave dhe përfaqësuesit e Ministrisë së Shërbimeve Publike.

Të organizohet dëgjim publik për Projektligjin për punë.

Grupi i punës i Projektligjit për punën është në këtë përbërje: Sadik Idriz - udhëheqës i grupit të punës, Nurishahe Hulaj - anëtare dhe Teuta Hadri - anëtare.

4. Të ndryshme

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e Komisionit se Komisioni për Bujqësi e ka amendamentuar Projektligjin për ushqimin pasi ka pranuar përgjigje nga Qeveria. Sipas këtij amendamenti Agjencia për Ushqim, i përcaktuar me nenin 36 të Projektligjit për ushqim, të kalojë në kuadër të Qeverisë, përkatësisht në Zyrën e Kryeministrit.

Sa i përket Ligjit për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, tha se i ka njoftuar Qeverinë, Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, Ministrinë e Punës dhe të Mirëqenies Sociale, por deri më tani nuk ka marrë përgjigje.

Flora Brovina – Lidhur me Ligjin për rehabilitimin profesional dhe për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, tha se Komisioni duhet t'i ftojë përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe të Financave në një nga mbledhjet e Komisionit. Ajo tha se ky ligj është i nevojshëm dhe është ligj avancues për shtetin tonë.

Qamile Morina – Propozoi që të planifikohet një vizitë në një qendër spitalore dhe një vizitë në pjesën veriore të Mitrovicës. Lidhur me implikimet buxhetore ajo tha se sponsoruesi ka dhënë shpjegime për vitet 2008 - 2010 dhe buxheti për MPMS-në nga viti i kaluar është rritur nga 149 milionë në 175 milionë.

Kryetari e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 12:15

Përgatitur nga
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz